



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 307/4 Prot.

Tiranë, më 28.3/2017

REKOMANDIM

Nr. 06 datë 28.3/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Universiteti "*Aleksandër Moisiu*" Durrës,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 43 datë 14/02/2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria e Hetimit Administrativ kreu hetim administrativ pranë kontrolluesit Universiteti "*Aleksandër Moisiu*" Durrës, me objekti kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Universiteti "*Aleksandër Moisiu*" Durrës.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin 43 datë 14/02/2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi Universiteti "*Aleksandër Moisiu*" Durrës, është një institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 801, datë 20/12/2005 "*Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës*".

Kontrolluesi Universiteti "*Aleksandër Moisiu*" Durrës, përpunon të dhëna personale kryesisht për subjektet e dhënave "*punëmarrës*", "*studentë*" dhe "*vizitorë*". Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër) si dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të tilla si sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), portali i studentit, portali zyrtar i institucionit, pajisje kompjuterike etj.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vend, është konstatuar se:

1. Kontrolluesi ka "*Njoftuar*" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, por konstatohet se nuk është deklaruar përpunimi i të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), qëllimi i përpunimit të këtyre të dhënave, përhapja e të dhënave drejt institucioneve të tjera etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të ligjit - "*1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është*

përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.”.

2. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Kontrolluesi ka vendosur kamera edhe në zyrë me 1, 2 ose 3 punonjës. Kontrolluesi nuk disponon rregullore apo udhëzime për funksionimin e këtij sistemi.
Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 5 (“1/b - në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime”), nenit 6 (Kriteret ligjore për përpunimin) dhe nenit 27 (“2/1. -Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara...”) të Ligjit.
3. Në ambientet e kontrolluesit janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), por ato nuk janë lehtësisht të dukshme dhe as në përputhje me modelin standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar.
Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit - “1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.”
4. Kontrolluesi ka publikuar në portalin zyrtar <http://www.uamd.edu.al> “Politikat e Privatësisë”, por konstatohet se informacioni i publikuar konsiston vetëm në zbatim të udhëzimit nr. 42 datë 22/07/2014 “Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë” dhe jo në lidhje me të dhënat të cilat mbledhen nëpërmjet këtij portali.
Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit - “1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...”
Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit online në internet, ka detyrim që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash, realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Publikimi i “Politikave të Privatësisë” përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.
5. Kontrolluesi nuk disponon rregullore për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale si dhe nuk ka nënshkruar “Deklaratën e Konfidencialitetit” me punëmarrësit të cilët kanë akses në të dhëna personale.

Mungesa e Rregullores për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale si dhe mos nënshkrimi i "Deklaratës së Konfidencialitetit", përbëjnë shkelje administrative të nenit 27 ("2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera."), nenit 28 (Konfidencialiteti i të dhënave) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit datë 05/08/2013 për "Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale". Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës specifikisht. Rregullorja përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Ajo duhet të përfshijë të gjitha llojet e përpunimit të të dhënave personale për çdo kategori të subjekteve të të dhënave.

6. Në ambientet kontrolluesit pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit janë të publikuara informacione të studentëve të cilat konsistojnë në emër, mbiemër, atësi, nr. Matrikulli, adresë e-Maili, notat etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të Kreut II, nenit 5 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Të dhënat personale që mbliidhen apo krijohen nga kontrolluesi me qëllim administrimin e proceseve mësimore dhe ofrimin e shërbimeve specifike për subjektet e të dhënave "studentë", nuk duhet të përpunohen jashtë kontekstit për të cilin ato janë grumbulluar dhe për më tepër, të cenojnë privatësinë e tyre.

Afishimi i të dhënave të studentëve në ambiente publike përbën shkelje administrative të nenit 5 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 7 të Komisionerit datë 09/06/2010 për "Përpunimin e të dhënave personale në institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin dhe e lexoi në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët u shprehën se: "Pretendimet do të paraqiten me shkrim pranë Zyrës së Komisionerit".

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 16/03/2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar.

Përfaqësuesit e kontrolluesit, në këtë seancë dëgjimore, paraqitën prova të cilat demonstuan rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, që konsistojnë në:

1. Përditësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave (në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit);
2. Hartimin e rregullores për "Përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të survejimit (CCTV)" dhe përfshirjen e saj në rregulloren e përgjithshme për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në U.A.M.D.";
3. Vendosijen e tabelave informuese (sipas modelit standard të miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave

- personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar në ambientet në të cilat kontrolluesi ushtron aktivitetin;
4. Publikimin e *“Politikave të Privatësisë”* në portalin zyrtar të kontrolluesit Universiteti *“Aleksandër Moisiu”* Durrës, e cila përfshin të dhënat personale që përpunohen në tërësi nga kontrolluesi;
 5. Hartimin e rregullores për *“Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në U.A.M.D.”*;
 6. Nënshkrimin e *“Deklaratës së Konfidençialitetit”* me të gjithë punëmarrësit e kontrolluesit;
 7. Marrjen e masave përkatëse (të cilat konsistojnë në heqjen e informacioneve të publikuara dhe ndalimin në vazhdimësi të afishimit të tyre në ambiente publike) në lidhje me afishimin e të dhënave të studentëve në ambiente publike të Universitetit *“Aleksandër Moisiu”*.

Në lidhje me pikën e dytë të konstatimeve sipas procesverbalit të datës 23/02/2017 në të cilin është konstatuar mbikëqyrje e zyrave nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV), provave të administruara, referuar kreut të II-të (Përpunimi i të dhënave personale) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar:

Neni 5 – Mbrojtja e të dhënave personale: *“1/b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime” dhe “2) Kontrolluesi është përgjegjës për zbatimin e këtyre kërkesave në të gjitha përpunimet automatike ose me mjete të tjera të të dhënave.”*

Neni 6 - Kriteret ligjore për përpunimin dhe

Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit datë 05/03/2010 *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar.

- *a- për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj të veçantë. Në këto raste është e nevojshme që të respektohen dispozitat e ligjit në fjalë;*
- *c- pa pëlqimin e subjektit por gjithnjë duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale””.*

konkludoj se kontrolluesi është në shkelje të neneve 5 dhe 6 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar.

Përdorimi i sistemit të video survejimit nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve. Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Qëllimi i regjistrimit duhet të specifikohet qartë dhe të jetë në përputhje me interesat ligjore të kontrolluesit. Regjistrimet mund të përdoren vetëm për hetimin e një ngjarje që ka sjellë dëmtimin e këtyre interesave të mbrojtura me ligj. Legjitimiteti i përdorimit të të dhënave personale të regjistruara për qëllime të tjera duhet të jetë i kufizuar vetëm për një interes të rëndësishëm publik.

Zyra e Komisionerit, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe ka reaguar në mënyrë të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6 dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar:
 - Të ndalojë mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-surveimit në zyrat e administratës;
 - Të heqë kamerat e pranishme në zyrat e administratës dhe;
 - Të shkatërrojë të gjitha të dhënat personale imazhe-video të cilat ndodhen në sistemin e video-surveimit (CCTV), të regjistruara nga kamerat e vendosura në zyrat e administratës.
2. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryhen plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikën e parë të këtij Rekomandimi, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
3. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 28.3/2017.

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI
